



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LICENSIMIT

AN221020200004

Tiranë, më: 12.01. 2021

Vendimi 02

DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “MINERALUNIT” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L28102601R

Adresa e selisë: Fshati Rajc Fushë, Prrenjjas, Librazhd, Elbasan

Personi përgjegjës: Ledion Emini

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzimi Kromi**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona Minerare Nr 690/6, Objekti “Katjel”, Njësia Administrative Rrajce, Bashkia Prrenjjas, Qarku Elbasan

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit ne mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon: Sugjerojmë verifikimin lidhur me zbatimin e procedurave, afateve dhe kërkesave

të përcaktuara në VKM nr. 247/2015 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

*Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, **në rast se** zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.*

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Sipërfaqja e kërkuar nuk bie në zonë të mbrojtur

2. Ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;

3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

4. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

- Nuk jepen masat që do të merren lidhur me rehabilitimin e sipërfaqes që do të shfrytëzohet.
- Në raportin e thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të

mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI

BLENDI KLOSI

Konceptoi:

Konfirmoi:

1. **Anex 1.Harta dhe koordinatat**

